

## NË EMËR TË POPULLIT

Gjykata Supreme e Kosovës, kolegji i përbërë nga gjyqtarët: Valdete Daka, kryetare, Rasim Rasimi dhe Agim Maliqi, anëtarë, me bashkëpunëtorin profesional Bujar Balaj, procesmbajtës, në çështjen penale të dënuarve M.Z., nga P. dhe Rr.R. nga S., për shkak të veprave penale shkelja e fshehtësisë së procedurës nga neni 400 par.2 lidhur me nenin 31 të KPK-së dhe veprës penale pengimi i të provuarit ose procedurës zyrtare në tentativë nga neni 28 dhe 394 par.1 nënpar.1.7 të KPK-së, duke vendosur lidhur me kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë, të ushtruar nga Prokuroria e Shtetit, të paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës PAKR.nr.336/16 datë 13 dhjetor 2016, në seancën e kolegjit të mbajtur më datë 04.04.2018, mori këtë

## A K T G J Y K I M

Refuzohet si e pabazuar kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë e Prokurorit të Shtetit, e paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës PAKR.nr.336/16 datë 13 dhjetor 2016.

## A r s y e t i m i

Gjykata Themelore në Mitrovicë, me aktgjykimin P.nr.51/2014 të datës 12 shkurt 2016, të dënuarin M.Z. e ka shpallur të “ pafajshëm “ për veprat penale shkelja e fshehtësisë së procedurës nga neni 400 par.2 lidhur me nenin 31 të KPK-së dhe veprës penale pengimi i të provuarit ose procedurës zyrtare në tentativë nga neni 28 dhe 394 par.1 nënpar.1.7 të KPK-së.

Është vendosur që shpenzimet e procedurës penale paguhen nga mjetet buxhetore. Ndaj të pandehurit Rr.R., është refuzuar aktakuza, pasi që prokurori është tërhequr nga ndjekja penale.

Duke vendosur në procedurën ankimore, Gjykata e Apelit të Kosovës, me aktgjykimin PAKR.nr.336/16 datë 13 dhjetor 2016, e ka refuzuar si të pa bazuar ankesën e Prokurorisë Speciale të Kosovës, të paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Mitrovicë P.nr.51/2014 datë 12 shkurt 2016, kurse e ka vërtetuar aktgjykimin e shkallës së parë.

Kundër këtyre aktgjykimeve, kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë ka paraqitur Prokuroria e Shtetit - prokurori i EULEX-it, përkitazi me të dënuarin M.Z. dhe atë vetëm përkitazi me veprën penale Shkelja e fshehtësisë së procedurës nga neni 400 par.2 në lidhje me nenin 31 të KPK-së, për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale nga neni 384 par.1 nënpar.12 të KPPK-së dhe shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale që kanë ndikuar në ligjshmërinë e vendimit gjyqësor sipas nenit 432 par.1 të KPPK-së, me propozim që Gjykata Supreme e Kosovës të veproj konform dispozitave të nenit 428 par.1 nënpar.1.3 dhe par.2 të KPPK-së.

Përgjigje në kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë ka dhënë mbrojtësi i të gjykuarit M.Z., av. G.E. nga Prishtina me parashtrësën e datës 25.07.2017.

Gjykata Supreme e Kosovës, në seancën e kolegjit pasi i shqyrtoi shkresat e lëndës, në kuptim të nenit 435 par.1 lidhur me nenin 436 par.1 të KPPK dhe pasi i vlerësoi pretendimet në kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë, konstatoi se:

Kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë është e pabazuar.

Prokurori i Shtetit në kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë, ndër të tjera thekson se kolegji i Gjykatës së Apelit në vlerësimin e saj ka dështuar që në mënyrë adekuate të analizoj ose të marrë parasysh faktet thelbësore që mbështesin argumentet e prokurorisë se i dënuari M.Z. kishte njohuri të drejtpërdrejt ose jo të drejtpërdrejt se dëshmitari A nuk ishte vetëm

dëshmitar por madje ishte dëshmitar i mbrojtur edhe pse këto fakte janë përshkruar qartë nga prokurori i EULEX-t në ankesën e ushtruar kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Mitrovicë. Po ashtu theksohet se gjykatat e instancës më të ultë kanë dështuar të bëjnë ndonjë gjetje në lidhje me elementin se nuk është dhënë autorizim për të zbuluar informatat kofidenciale përkundër faktit se është një element i rëndësishëm për të dëshmuar ose hedhur aktakuzën. Gjithashtu theksohet se të gjitha provat e prezantuara në gjykim kundër të dënuarit M.Z., ishin të mjaftueshme për gjetjen e fajësisë për veprën penale. Mirëpo, duke anashkaluar faktet kyçe dhe madje duke mos vlerësuar kërkesën alternative të rikualifikimit të formave të përgjegjësisë dhe gabimisht duke marr parasysh fakte tjera të pa rëndësishme, si bie fjala se i dënuari M.Z., e kishte par urdhrin e gjykatës dhe se dëshmitari M.M., ishte i afërt i dëshmitarit A dhe prandaj mund të supozohej se tashmë kishte dijeni për situatën e dëshmitarit A, kolegji në mënyrë të gabuar e ka hedhur poshtë ankesën e Prokurorit të Shtetit-të EULEX-it.

Sipas vlerësimit të kësaj Gjykate, pretendimet e prokurorit të paraqitura në kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë lidhur me shkeljet esenciale të dispozitave të procedurës penale nga neni 384 par.1 pika 12 të KPPK, janë të pabazuara, meqenëse në rastin konkret nuk ka shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale, për faktin se gjykata e shkallës së parë dhe ajo e shkallës së dytë i kanë vlerësuar provat në pajtim me dispozitat e KPPK, kurse për provat kontradiktore kanë dhënë në mënyrë të plot arsyetim se cilat fakte dhe për çfarë arsye janë marrë si të provuara ose si të paprovuara, duke bërë vlerësimin e ligjshëm të tyre. Gjykatat e instancës më të ultë kanë bërë vlerësimin dhe analizën e të gjitha provave të administruara gjatë shqyrtimit gjyqësor dhe lidhur me to kanë paraqitur konkludime të qarta, ndërsa faktet vendimtare të çështjes janë vërtetuar drejt dhe në mënyrë të plotë. Qasja e tyre ndaj fakteve vendimtare ka qenë e drejtë dhe e ligjshme, sepse ka mbështetje në provat e administruara, kështu që asnjë fakt vendimtar në këtë çështje penalo-juridike nuk ka ngelur pa u arsyetuar sipas kërkesave ligjore.

Gjykata Supreme pranon në tërësi qëndrimin juridik të gjykatës së shkallës së parë dhe asaj të shkallës së dytë, të shprehur në aktgjykimet e tyre, përkitazi me pafajësinë e M.Z., duke gjetur

se në veprimet e tij nuk manifestohen elementet objektive dhe subjektive të veprës penale për të cilën akuzohet, meqenëse me asnjë provë nuk është vërtetuar se i dënuari ditën kritike ka zbuluar informacione në lidhje me dëshmitarin A nga mundësia e të qenurit dëshmitar i rastit për krime të luftës, as për publikun e as për askënd tjetër nga M.Z. Po ashtu qëndron fakti se është vërtetuar nga gjykata e shkallës së parë se i dënuari M.Z. nuk ishte në posedim të urdhrit dhe se një urdhër i tillë nuk është gjetur edhe përkundër kontrollës në banesën, vendit të punës dhe automjetit të M.Z. Bazuar edhe në deklaratat e dëshmitarëve H.M., M.M. dhe dëshmitarit A, deponuar në seancën e shqyrtimit gjyqësor të datës 09 dhe 10 dhjetor 2015, gjykata ka konstatuar se nuk ishte dëshmuar se i dënuari M., kishte marrë informata kofidenciale nga Rr.R. në lidhje me dëshmitarin A. Konstatimi i Prokurorit të Shtetit se i dënuari mund të supozonte se dëshmitari A, ndoshta ishte dëshmitar në rastin Drenica, nuk mund të jetë provë në favor të prokurorisë kur dihet se Gjykata aktgjykimin nuk mund t`a mbështetë në supozime por në prova të vërteta në shqyrtimin gjyqësor siç me të ka vepruar gjykata e shkallës së parë e që është vërtetuar edhe nga ana e gjykatës së shkallës së dytë të cilin si të drejtë dhe ligjore e vlerëson edhe kjo Gjykatë.

Nga të gjitha këto që u thanë më lart, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, e konform dispozitës së nenit 437 të KPPK.

#### GJYKATA SUPREME E KOSOVËS - PRISHTINË

Pml.nr.71/2017, më datë 04.04.2018

Procesmbajtës,  
Bujar Balaj

Kryetare e kolegjit,  
Valdete Daka